



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, më 23.09.2022

Vendimi nr. 36/22

Duke u bazuar në nenet 11,13,15,16,17,18,26,27 dhe 55 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 23.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve AGROFERT dhe SKW Stickstoffwerke Piestertitz GmbH (blerësit) për blerje të 100% të aksioneve mbi ndërmarrjet Borealis AG dhe Borealis France S.A.S (shitësit)

AGROFERT është shoqëri aksionare, me seli të korporatës në Pyšelská 2327/2, 14900 Praha 4, Chodov, Republika Çeke, e regjistruar në Regjistrin e Kompanive të Gjykatës Komunale të Pragës nën B 6626, me numër identifikimi 261 85 610 dhe SKW Stickstoffwerke Piestertitz GmbH, shoqëri gjermane me përgjegjësi të kufizuar, me seli të korporatës në Lutherstadt Wittenberg, Gjermani, regjistruar në regjistrin komercial të gjykatës lokale (Amtsgericht) Stendal, Gjermani, me numër regjistrimi HRB 11869. AGROFERT, prodhon plehra të drejtpërdrejta azotik dhe të përbëra si dhe produkte teknike të azotit, duke përfshirë amoniakun, acidin nitrik, urea e nitrat të amoniakut teknik dhe AdBlue.

Borealis AG është shoqëri aksionare me seli korporate në Vjenë, Austri dhe e regjistruar në regjistrin komercial austriak me numër regjistrimi FN 269858a dhe Borealis France S.A.S., shoqëri aksionare e thjeshtuar me seli të korporatës në Courbevoie, Francë dhe e regjistruar me numër regjistrimi 424 367 134 RCS Nanterre.

Ndërmarrjet e synuara: Borealis Agrolinz Melamine GmbH, Borealis L.A.T GmbH, Feboran EOOD, Borealis L.A.T Italia s.r.l. Borealis Agrolinz Melamine Deutschland GmbH. Borealis Chimie S.A.S. Borealis Produits et Engrais Chimiques du Rhin S.A. (PEC Rhin). Borealis L.A.T France S.A.S.. Përkitazi me aktivitetin e prodhimit, Ndërmarrjet të Synuara janë të vendosura në Austri, Francë dhe Gjermani.

III. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 € (njëqind euro) dhe për Vendimin për lejimin e Përqendrimit në vlerë prej 3,000.00 € (tre mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 09.08.2022, ka pranuar kërkesën me numër të protokollit 215/22-01/H, lidhur me njoftimin për Përqendrim të ndërmarrjeve për përqendrim përmes znj. Afrone Shaipi, përfaqësuese ligjore nga Pallaska and Associates për ndërmarrjet AGROFERT dhe SKW Stickstoffwerke Piestertitz GmbH për blerje të 100% të aksioneve mbi ndërmarrjet Borealis AG dhe Borealis France S.A.S (shitësit).

Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se Ndërmarrjet e Synuara janë aktive në Republikën e Kosovës vetëm me shitjen e plehrave azotike dhe të atyre të përbëra/përziera që përmbajnë azot (dhe lëndë ushqyese tjera). Ndërmarrjet e Synuara nuk janë aktive me shitje të produkteve teknike të azotit (apo ndonjë produkti tjetër) në Republikën e Kosovës.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i lëndës/dokumentacionit
2. Vërtetimi për kërkesën e dorëzuar me datë 23.08.2022.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit ne ueb faqen e AKK-së me datë 26.08.2022

Kërkesa për Përqendrim është bazuar në marrëveshjen e paleve për shitblerjen e aksioneve, të datës 28.07.2022, ku palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për shitblerjen të aksioneve, ndërmjet Agrofert dhe SKW Piesteritz në njërën anë dhe shitësit në anën tjetër, që Agrofert synon të marrë kontrollin individual mbi biznesin e plehut, azotit teknik dhe melaminës të shitësve, tash e tutje referuar Ndërmarrje e Synuar. Andaj, në baze të kërkesës Sekretariati i Autoritetit ka bërë vlerësimin e Kërkesës për Përqendrim.

Baza Ligjore dhe Akti i Përqendrimit

- a) Qarkullimi i brendshëm, kalon shumë më 1,000,000.00 euro.
- b) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë, kalon shumë më 20,000,000.00 euro.
- c) Kontrata e shitëblerjes është lidhur me datën 28.07.2022 ndërmjet ndërmarrjeve AGROFERT dhe SKW Stickstoffwerke Piestertitz GmbH për blerje të 100% të aksioneve mbi ndërmarrjet Borealis AG dhe Borealis France S.A.S .

Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu Relevant: Transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte në konkurrencë në tregun e Kosovës, duke marrë parasysh se nuk ka ngjashmëri ndërmjet aktivitetit të AGROFERT dhe Ndërmarrjes së Synuar në Kosovë, për këtë arsye tregu relevant mbetet i hapur, AGROFERT nuk shet në Kosovë.

Tregu i Produktit - ka të bëjë me nxjerrjen, prodhimin dhe furnizimin e plehrave azotike, produkteve teknike të azotit dhe melaminës.

Tregu Gjeografik - Tregu gjeografik përkufizohet si treg i hapur

Tregjet e prekura - Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që shitësi dhe blerësi nuk janë aktivë në Kosovë në mënyrë të drejtpërdrejtë e as në mënyrë të tërthortë, tregje të prekura nuk ka në tregun kosovar sepse Ndërmarrjet e Synuara do të shesin vetëm plehra, përkatësisht tregu kosovar ofron shitjen e plehrave, rrjedhimisht nuk ka rritje të pjesës së tregut.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se, njëra nga palët (Ndërmarrjet e Synuar) shesin plehra kimike, në territorin e Republikën së Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë, në fakt as blerësi dhe as shitësi nuk operojnë në Kosovë dhe nuk gjerojnë të ardhura në Republikën e Kosovës. Ndërmarrjet e përfshira në Përqendrim, nuk do të kenë efekt negativ në tregun e Republikës së Kosovës, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

IV. Ky vendim, hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit, nga Komisioni.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare

